

VENDIM
Nr. 82/2015

**PËR CAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT MUJOR FIKS TË ANËTARIT TË
KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të nenit 98, pika 1, të ligjit nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republike e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Masa e shpërblimit mujor fiks të anëtarit të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar është 30 për qind e masës së përcaktuar në pikën D/7 të lidhjes nr. 1 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar.

II. Efektet e këtij vendimi shtrihen nga konstituimi I Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 23.7.2015

KRYETARI
Ilir Meta